



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës



Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Vendimi nr.33/18

Data: 14.05.2018

Në bazë të 28 dhe 29 Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, neni 8, neni 35 paragrafi 1.2, 2, neni 50, neni 54 paragrafi 1.3 dhe 1.9, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi 1.3 Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar, Komisioni i Autoritetit Kosovar të Konkurrencës në mbledhjen e datës **14.05.2018** mori këtë:

V E N D I M

- I. LEJOHET**, Përqendrimi përmes përfitimit 100% të kontrollit nga NEREGELIA TRADING LTD dhe Beta Group Shpk., në cilësinë e blerësve **mbi** ALL BALCANS CORPORATION sha., në cilësinë e shitësit.
- II.** Nuk ka asnjë shqetësim në pikëpamje të kriterëve për vlerësimin e përqendrimit të lejuar sipas nenit 19 të Ligjit.
- III. Parashtruesi i Njoftimit për Përqendrim** obligohet të paguaj taksë administrative prej 100.00 €, me shkronja (njëqind euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me Nenin 20 të Ligjit Për Mbrojtjen e Konkurrencës, dhe neni 20 të Udhëzimit Administrativ Nr.06/2012, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 3,000.00 € me shkronja (tre mijë euro).

A R S Y E T I M

Pas pranimit të Njoftimit për Përqendrim, e paraqitur në bazë të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Plotësim Ndryshimi i tij, Ligji nr. 04/L-226, neni 18 par 6, neni 19 par 5, neni 28, paragrafi (1,2), neni 35 paragrafi (2), neni 36, Udhëzimit Administrativ Nr. 06/2012, neni 18 dhe 20 paragrafi (1.3) Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e

Përqendrimit të Ndërmarrjeve, Njoftimit për realizimin e përqendrimit ne ueb faqen e AKK me datë 13.04.2018, Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 16.04.2018, Sekretariati ka përgatitur këtë raport:

Njoftimi për Përqendrim ka të bëjë me:

Blerjen (aksioneve) të nënshkruar më datë **02.03.2018** (Kontratë e Shitblerjes) ndërmjet NEREGELIA TRADING LTD dhe Beta Group Shpk., në cilësinë e blerësve (në vijim bashkërisht te quajtur **“Blerësit”**) dhe Elizabeth CUTTING MCFADDEN, Iro PAPATHANASOPOULOU, Petro KUMI, Ilias ASIMAKOPOULOS, Ilias VOUTERIS, Georgios MELA, Ioannis-John KYNIGOPOULOS në cilësinë e shitësve (në vijim bashkërisht quajtur **“Shitësit”**).

Ndërmjet Kontratës së Shitblerjes do të realizohen transferimi i 100% i pronësisë së ALL BALCANS CORPORATION Sha. si (**palë shitëse**), një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, regjistruar në Regjistrin Tregtar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit, me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) K51414005B, me seli në adresën Rruga Gjergj Legisi, ish Umb, Laprakë- Tiranë Shqipëri, tek (**pala blerëse**) NEREGELIA TRADING LTD Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Qipros, me numër HE 9551, me seli në adresën Griva Digeni, Godina Panyides, Kati 2, Zyra 3, P.O.Box 56250,3305, Limassol, Qipro dhe Beta Group Shpk., shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar sipas legjislacionit të Republikës së Kosovës, regjistruar në Regjistrin e Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtare të Kosovës pranë Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, me numër 810027468, me seli në adresën Rr. Sadik Shala, Lipjan, Kosovë.

Baza ligjore dhe akti i Përqendrimit

Sipas nenit 15, të Ligjit 03/L-229 Për Mbrojtjen e Konkurrencës, përmbushet detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që:

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në mbarë botën, kalon shumë 20 milion euro
- b) Njëra nga palët blerëse është e regjistruar në Republikën e Kosovës
- c) Kontrata e Shitblerjes ndërmjetës palëve, datë 02.03.2018.

Blerja e propozuar gjithashtu është lajmëruar edhe tek Autoriteti i Konkurrencës në Shqipëri.